



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. ___ Prot

Polican , me ___. ___. 2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë 21.08.2023, në Bashkinë Polican , nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrin e prokurimit nr. 39, datë 21.8.2023, të titullarit të autoritetit kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

Objekti i Procedurës: “Mbikqyrje e punimeve per objektit:“ **Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavaresise" dhe sistemimi i jashtem i gjithe kompleksit Arsimor**

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Shërbime për mbikqyrje të ndertimit - 71521000-6.

Vlera e fondit limit: 1 553 952 (nje milion e peseqind e pesedhjete e tre mij e neneteqind e pesedhjete e dy leke)pa tvsh.

Detyrimi i përzgjedhjes së mbikëqyrësit është përcaktuar në :

- nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, cituar “*Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve*”.
- Nenin 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, cituar “*Mbikëqyrja e punimeve bëhet për të gjitha llojet e objekteve të ndërtimit dhe kryhet ngambikëqyrës/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat dhe standardet teknike të projektimit, zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh edhe anëkonomike të tij*”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar; Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar

standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 dhe 55/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera (*jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës*) është përcaktuar sipas vlerës së parashikuar në rregullat e prokurimit publik për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore (2020, 2021 dhe 2022) është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas së cilës “*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

2.2.3 Një dokument lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 dhe për keestet e maturuara të vitit 2023, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin për të gjitha vendet ku ushtron aktivitet sipas ekstratit të QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuesedo të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*)

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të ulët se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në shkronjën b), të pikës 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, të kryera gjatë tre viteve, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të jenë të licensuar për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj kontrate. Ato duhet të disponojnë pikat e mëposhtme të licencës për mbikëqyrje punimesh (sipas VKM nr. 759, datë 12.11.2014, të ndryshuar):

- NP-1 (Punime gjermimi në tokë);
- NP-3 (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada);
- NP-7 (Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje);
- NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve);
- NS-2 (Impjante hidrosanitare etj);
- NS-4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese);
- NS-8 (Ndertime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri) ;
- NS-12 (Impjante teknologjike, termike dhe te kondicionimit);
- NS-14 (Impjante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV).
- NS-18 (Punime Topogjeodezike)

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do

të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse dhe të regjistrohet në regjistrat profesionale të subjekteve të licencuara në këto fusha, bazuar në rregulloren bashkëlidhur këtij vendimi”.

Licensat si më sipër, janë vendosur duke pasur parasysh natyrën e punimeve të kontratës bazë, të parashikura në projekt-preventivat e dërguara nga strukturat përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Konkretisht:

Llojet e licencave sipas klasifikimit të tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur për secilën natyrë pune, sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Konkretisht:

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar, kategoria **N.P – 1** është për “Punime gjurmimi në tokë”:

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara në preventiv,

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar, kategoria **NP-3** është për “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”.

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve objekt kontrate dhe i referohet të gjithë zërave të parashikuara në preventivin e punimeve të këtij objekti, pasi në tërësi kemi të bëjme me rikonstrukcion të një objekti ekzistuese.

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar, kategoria **NS-1** është për “Punime për prishjen e ndërtimeve”.

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara, Kreu A “Punime Ndërtimi”, seksioni “Punime prishje dhe cmontimi dhe riparime”, referuar preventivit të punimeve (zërat me numër rendor A-1.1 – A-1.8).

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar kategoria **NS-2** është për “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”.

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara, në preventivin “Punimet hidraulike”.

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar kategoria **NS-4** është për “*Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese*”.

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara në preventiv, “Punime Ndërtimi”, seksioni “Punime murature “Punime suvatimi e veshje”, “Punime dyer e dritare “Punime bojatisje”, si dhe punimet e tjera të kësaj natyre të parashikuara në kapitullin/jt përkatës.

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar, kategoria **NS-8** është për (*Ndertime parafabrikat betonarme, struktuta metalike dhe druri*).

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara në preventiv, seksionit “Punime Ndërtimisi dhe seksionit “Punime konstruksioni”, zëri i punimeve “F.V konstruksion

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar, kategoria **NS-12** është për (*Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit*);

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara në preventiv, në seksionin “Preventivi HVAC”.

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar,, kategoria **NS-14** është për “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”.

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara në preventiv, “Preventiv i punimeve elektrike dhe elektronike”.

Sipas VKM nr. 759 datë 28.12..2016, të ndryshuar,, kategoria **NS-18** është për “punime topogjeodezike”.

Kjo kategori licence është e domosdoshme për mbikqyrjen e punimeve të parashikuara në preventiv, kryesisht punime te piketitmit, nxjerrjes se kuotave

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

Dëshmi për stafin teknik:

- a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:
- | | |
|-------------------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 2 (dy) |
| - Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| - Inxhinier Mjedisi/Kimist teknolog | 1 (një) |
| - Inxhinier Gjeodet/topograf | 1 (një) |

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune;
- Diplomën universitare.
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 759, datë 12.11.2014, të ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

b) Gjithashtu, OE duhet të kenë si staf mbështetës edhe

- Inxhinier Elektronik/inxhinier IT 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Ndertimi 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune;
- Diplomën universitare;
- Duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

c. Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për zbatimin e kontratës duhet të disponojë *min 1 (një) inxhinier të certifikuar si ekspert zjarrëfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë të paktën per Periudhen 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST, ose mund të sigurohen nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.

Kërkesat e shkronjave a) b) dhe c), të pikës 2.2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/b) dhe c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Drejtuesit teknik si më sipër janë vendosur duke pasur parasysh natyrën e punimeve të kontratës bazë, si dhe janë të nevojshëm për kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektet, kushtet teknike të projektimit, zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij.

Stafi mbështetes i inxhinierëve është kerkuar per tu ardhur ne ndihme stafit teknik, pasi objekti ka shtrirje te madhe ne terren dhe do te punohet paralelisht ne disa nenobjekte. Per te pasur nje kontroll sa me te mire te punimeve kerkohet dhe stafi mbështetes.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projekt-preventivin e zbatimit të punimeve.

Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të saktë, në përputhje me projekt-preventivin dhe legjislacionin e fushës përkatëse, të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit A (Punime Ndërtimi).
- **Arkitekti** është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të saktë, në përputhje me projekt-preventivin dhe legjislacionin e fushës përkatëse, të punimeve të rifiniturës, sipas parashikimeve në projekt.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të saktë, në përputhje me projekt-preventivin dhe legjislacionin e fushës përkatëse, të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar preventivit në seksionin “Preventivi HVAC”.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të saktë, në përputhje me projekt-preventivin dhe legjislacionin e fushës përkatëse, të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar preventivit të “Punimet hidraulike”.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të saktë, në përputhje me projekt-preventivin dhe legjislacionin e fushës përkatëse, të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve referuar preventivit të instalimeve elektrike.
- **Inxhinieri Elektronik** është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të saktë, në përputhje me projekt-preventivin dhe legjislacionin e fushës përkatëse, të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve referuar preventivit të punimeve elektronike (“Furnizim pajisje elektronike”; ” Sistemi i sigurise dhe kontrolli i hyrje daljeve”: ” CCTV”).
- *Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4;

të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin“, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Ky ekspert përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të saktë, në përputhje me projekt-preventivin dhe legjislacionin e fushës përkatëse, të punimeve, të kapitullit “Preventivi MNZ”,

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001:2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë.

2.3.5 *Operatorët ekonomike duhet të kenë paisjet dhe automjetet si më poshtë:*

- Gps 1 cope;
- Total station 1 cope;
- Automjet. 1 cope

- a) Per pajisjet operatori ekonomik duhet te paraqesi dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre, apo marrjen me qira te tij si psh: Fature tatimore te shitblerjes, kontrate shitblerje ose kontrate qiraje te noterizuar.
- b) Per mjete qe shenohen ne regjistrat publike (automjetet) duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit/ certifikate pronesie, siguracionin e mjetit, certifikaten e kontrollit teknik, , leje qarkullimi.
- c) Per mjetet e siguruara me qira, dokumentat e mesiperme duhet te shoqerohen edhe me kontraten perkatese noteriale te qirase/ leasing /furnizimit/bashkepunimit /huaperdorjes e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

Shënim: Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 9 ne DST.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3.6 Për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatorët Ekonomikë duhet të kenë parasysh sa më poshtë:

- 1. Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.**
- 2. Të gjitha ofertat që do të jenë më të ulëta se vlerat minimale të lejuara në bazë të parashikimeve të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, do të refuzohen.**
- 3. Zërat e punimeve të parashikuara, janë sipas preventivit të punimeve, bashkëlidhur DST-ve.**

Shënim: Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...*

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Shënim: Në respekt të nenit 36 të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik në të gjithë rastet kur dokumentet e tenderit përmendet markë e veçantë përfshihet termi “ose ekuivalent i tij/ i saj”.

Kudo në specifikimet Teknike ku është cituar Standart ndërkombëtar do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Në cdo rast, përmendja e markave të veçanta nëse është rasti bëhet vetëm me qëllim orientimi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 7/1, të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, ku parashikohet se: “*Tarifat për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik*”.

Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjitha kriteret e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me kriteret e kërkuara në kontratën bazë me objekt **Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavaresise" dhe sistemimi i jashtëm i gjithë kompleksit Arsimor**

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT

Ferdinand Avdiaj

Sara Satka

Kristina Roma